



CRNA GORA - MALI I ZI

GLAVNI GRAD PODGORICA- KRYEQYTETI PODGORICA

Opština u okviru Glavnog grada- Tuzi - Komuna në kuadër të Kryeqytetit- Tuz

**SKUPŠTINA OPTINE – KUVENDI I KOMUNËS**

**Komisija za raspodjelu sredstava NVO-Komisioni për shpërndarjen e mjeteve OJQ**

Br. Nr. 23-030/18-2089

Tuzi-Tuz, 30.05.2018. godine

Në bazë të nenit 4 paragrafi 1 të Vendimit mbi kriteret, mënyrën dhe procedure e shpërndarjeve të mjeteve organizatave joqeveritare (“Fleta zyrtare e Malit të Zi- dispozitat komunale”, nr. 013/18 të datës 20.04.2018), Komisioni për shpërndarjen e mjeteve organizatave joqeveritare, shpallë

## **KONKURS PUBLIK**

### **për shpërndarjen e mjeteve nga buxheti i komunës së Tuzit, të planifikuara për organizata joqeveritare për vitin 2018**

1. Ftohen organizatat joqeveritare të regjistruara në Mal të Zi me seli në komunën e Tuzit, të cilat janë të regjistruara deri në ditën e shpalljes së këtij Konkursi, që të dorëzojnë fletëparaqitjet e veta për konkurs për shpërndarjen e mjeteve nga buxheti të dedikuara për financimin e OJQ-ve të komunës në kuadër të Kryeqytetit- Tuz, për vitin 2018, për projekte që realizohen në territorin e komunës së Tuzit.
2. Fushat prioritare për vitin 2018, në të cilat nga buxheti i Komunës së Tuzit do të ju ofrohet mbështetje financiare për realizimin e projekteve të organizatave joqeveritare dhe të cilat do të kenë përparësi gjatë vlerësimit dhe sjelljes së vendimit mbi financimin e projekteve të organizatave joqeveritare janë:
  - Ekologjia, mbrojtja e ambijetit dhe shëndetit të qytetareve;
  - Aktivitetet Sociale humanitare (mbështetje për qytetarët e cenueshëm social, mbështetje për të moshuarit dhe personat me invaliditet, mbështetje për njerëzit me aftësi të kufizuara);
  - Trashëgimia kulturore, ruajtja e trashëgimisë historike.
3. Konkursi për shpërndarjen e mjeteve është i hapur 20 ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore dhe web faqen e komunës përkatësisht Kryeqytetit Podgorica [www.podgorica.me](http://www.podgorica.me), përfundimisht me 18.06.2018 deri në ora 16:00.
4. Paraqitja në konkurs dorëzohet në formularin e përshkruar dhe dorëzohet në zyrën e komunës në kuadër të Kryeqytetit- Tuz.
5. Së bashku me fletëparaqitje, në zarf të vulosur, duhet dorëzuar:
  - Vendimi mbi regjistrimin në regjistrin e organizatave joqeveritare;

- një kopje të raporteve financiare (bilanci dhe llogaria e fitimit dhe humbjes) për vitin e fundit fiskal (përveç nëse organizata është e regjistruar në vitin kalendarik kur është shpallur konkursi);
- projektin me të cilin organizata joqeveritare konkurren për ndarjen e mjeteve;
- të dhëna mbi përvojën e të punësuarve, gjegjësisht vullnetarëve në organizatë joqeveritare me punë të ngjashme (referenca);
- vërtetim mbi dorëzimin e pasqyrave financiare;
- raportin mbi projektet e realizuara në vitin paraprak, duke përfunduar me datën e shpalljes së konkursit;
- një garanci (deklaratë) të një personi të autorizuar për përfaqësimin e organizatës joqeveritare që nuk ka marrë mjete nga donatori tjetër në shumën e përgjithshme të nevojshme për realizimin e projektit me të cilin kandidohet;
- deklaratë nëse organizata joqeveritare ka dorëzuar projektin e parashikuar një donatori tjetër për shqyrtim në periudhën e mëparshme ose në kohën e paraqitjes në konkursin e Komunës;
- tre versione të shtypura dhe një elektronike të projektit në CD.

Organizata joqeveritare, së bashku me dokumentacionin e lartpërmendur, mund të dorëzojë rekomandimet e ekspertëve ose dokumentacionin tjetër përkatës.

#### 6. Projekti duhet të përmbajë:

- 1) emrin e organizatës, me të dhënat themelore (selinë, kontakt tel / fax, e-mail, numri i të punësuarve, qëllimet e organizatës);
- 2) emrin e projektit;
- 3) zonën me prioritet të kategorisë së projektit;
- 4) përmbajtjen e shkurtër të projektit;
- 5) përshkrimin e problemit;
- 6) qëllimet e projektit;
- 7) një përshkrim të lidhjes së projektit me politikat publike (strategjitë, planet e veprimit, aktet ligjore dhe nënligjore) në fushën e caktuar të miratuar nga Komuna ose shteti)
- 8) një përshkrim të grupit të synuar;
- 9) një përshkrim të hollësishëm të aktiviteteve të projektit;
- 10) afati i fundit për zbatimin e projektit;
- 11) mënyrën e monitorimit dhe vlerësimit të suksesit të realizimit të projektit;
- 12) qëndrueshmëria e projektit;
- 13) buxheti i projektit dhe shuma e mjeteve për të cilat konkurren, shuma e mjeteve të veta (pjesëmarrja), si dhe shuma e mjeteve të miratuara për të njëjtin projekt ose program nga donatorë të tjerë, nëse këto fonde janë aprovuar;
- 14) një përshkrim të shkurtër të projekteve të zbatuara në vitin paraprak;
- 15) një përshkrim të shkurtër të organizatës partnere dhe projekteve të realizuara në vitin paraprak (nëse ka);
- 16) emri dhe mbiemri i personit përgjegjës për realizimin e projektit ose programit me të dhënat e kontaktit;
- 17) informacion mbi anëtarët e organit drejtues të organizatës;
- 18) numri i xhirologarisë dhe NID i organizatës.

7. Komisioni nuk do të mbështesë projektet të cilat:

- Nuk kanë kushte formale për drejtimin e një projekti (dokumentacioni i paplotë ose i pasaktë)
- Projekti pasqyron padijeni serioze dhe paragjykime lidhur me problemin
- Projekti nuk ka një pamje të qartë të rezultateve – arritjeve në pjesën e vlerësimit të brendshëm - vlerësimit
- Aktivitetet e planifikuara jashtë Komunës nuk do të merren parasysh
- Propozimi i projektit është në formën e duhur, por mungon informacioni kyç
- Aktivitetet e parashikuara nga projekti tashmë ekzistojnë dhe nuk ka arsye të justifikuara për zbatimin e tyre
- Disproporcioni i dukshëm i buxhetit të projektit dhe aktiviteteve të përfshira në projekt.

8. Komisioni bën shpërndarjen e mjeteve në bazë të projektit i cili bashkë me fletëparaqitje në konkurs dorëzon OJQ, duke vlerësuar kriteret e përcaktuara me nenin 18 të Vendimit mbi kriteret, mënyrën dhe procedure e shpërndarjeve të mjeteve organizatave joqeveritare (“Fleta zyrtare e Malit të Zi- dispozitat komunale”, nr. 013/18 të datës 20.04.2018).



**KRYETARI KOMISIONIT**

Naser Krkanoviq